



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

---

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

**RAPORTI VJETOR**  
**I KËSHILLIT TË PAVARUR MBIKËQYRËS**  
**PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

**2010**

**PRISHTINË, MARS 2011**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>I. SHKURTESAT .....</b>	<b>3</b>
<b>II. HYRJE .....</b>	<b>4</b>
<b>III. PJESA E PËRGJITHSHËME .....</b>	<b>5</b>
<b>IV. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I KËSHILLIT .....</b>	<b>6</b>
<b>V. FUNKSIONET E KËSHILLIT .....</b>	<b>6</b>
<b>VI. FUNKSIONI I ANKESAVE.....</b>	<b>7</b>
a. Ankesat sipas objektit .....	7
b. Struktura gjinore e ankuesve .....	7
b. Struktura nacionale ankuesve.....	8
d. Ankesat e ushtruara kundër vendimeve të organeve të punësimit .....	9
<b>VII. ANKESAT E PARAQITURA NË KPMSHCK GJATË VITIT 2010.....</b>	<b>10</b>
<b>VIII. ANKESAT E SHQYRTUARA GJATË VITIT 2010 .....</b>	<b>18</b>
<b>IX. ANKESAT E ZGJIDHURA GJATË VITIT 2010 DHE MËNYRA E ZGJIDHJES SË TYRE .....</b>	<b>22</b>
1. Ankesat e zgjidhura .....	22
2. Mënyra e zgjidhjes së ankesave.....	<a href="#">23</a>
3. Ankesat e aprovuara, pjesërisht të aprovuara dhe ex-officio dhe ekzekutimi i tyre.....	23
<b>X ZBATIMI I VENDIMEVE TË KMPHCK-së NGA ORGANET E PUNËSIMIT.....</b>	<b>25</b>
<b>XI. FUNKSIONI I MBIKËQYRJES .....</b>	<b>27</b>
<b>XII. FUNKSIONI I VËZHGIMIT .....</b>	<b>31</b>
<b>XIII. BUXHETI .....</b>	<b>34</b>
<b>XIV. BASHKËPUNIMI .....</b>	<b>35</b>
<b>XV. PROBLEMET DHE VËSHTERËSITË.....</b>	<b>37</b>
<b>XVI. SFIDAT E SË ARDHMES .....</b>	<b>37</b>
<b>XVII. PERFUNDIMI .....</b>	<b>38</b>

**I. SHKURTESAT**

1. MAP - Ministria Administratës Publike
2. MAPL - Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal
3. MASHT- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
4. MBPZHR - Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
5. MD - Ministria e Drejtësisë
6. MEF - Ministria e Ekonomisë dhe Financave
7. MEM - Ministria e Energjisë dhe Minierave
8. MFSK - Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
9. MKK - Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit
10. MKRS - Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve
11. MMPH- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
12. MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
13. MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
14. MSH - Ministria e Shëndetësisë
15. MTPT - Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit
16. MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
17. APP - Agjencia e Prokurimit Publik
18. IAP - Institucioni i Avokatit të Popullit
19. AKK - Agjencia Kadastrale e Kosovës
20. QKUK - Qendra Kline Universitare e Kosovës
21. QKSPEZH - Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim
22. ASHAK - Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës
23. QS - Qendra e Studentëve
24. UP - Universiteti i Prishtinës
25. ESK - Enti i Statistikave të Kosovës
26. IKAP - Instituti i Kosovës për Administratë Publike
27. ATK - Administrata Tatimore e Kosovës
28. IGJK - Instituti Gjyqësor i Kosovës
29. AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit
30. KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
31. ZAGJ - Zyra e Auditorit Gjeneral
32. EULEX - Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit
33. OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
34. UNDP - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
35. IOM - Organizata Ndërkombëtare për Migrim
36. KPMK - Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës
37. UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
38. SHCK - Shërbimi Civil i Kosovës
39. KE - Kryeshefi Ekzekutiv ( agjencisë ekzekutive)
40. APK - Agjencioni Pyjor i Kosovës
41. UA - Urdhëresa Administrative (2003/2)
42. LPA - Ligji i Procedurës Administrative
43. UA - Udhëzimet Administrative(2008/01 dhe 2008/02)
44. OP - Organi i Punësimit
45. DFID - Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar
46. QIF-Qendra e Inteligjencës Financiare

## II.HYRJJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) është i paraparë në aktin më të lartë Juridik të Republikës së Kosovës, konkretisht me nenin 101 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është organ i pavarur që i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli fillimisht është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe ka filluar të funksionojë në vitin 2004 në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike.

Me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores Nr. 2001/36 të datës 27 shkurt 2008, Këshilli është njësi e mëvetësishme, që i raporton në mënyrë të drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës dhe Kuvendi të gjitha raportet e Këshillit ia përcjell Kryeministrit.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar edhe Ligjin nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me 30 gusht 2010. Gjithashtu edhe sipas këtij Ligji Këshilli është organ i pavarur i cili për punën e vet i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Funksionet e Këshillit janë të përqendruar në shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civil dhe aplikuesve për punësim në shërbimin civil të Kosovës, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil dhe vëzhgimin e zgjedhjes së nëpunësve civil te nivelit drejtues dhe niveleve të njëjta ne Institucionet e Kosovës.

Baza ligjore për funksionimin e Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-028 për Proceduarën Administrative dhe aktet nënligjore që implementojnë këto ligje.

Këshilli gjatë gjithë vitit 2010, fuqishëm ka qenë i angazhuar në përpjekje që të sigurohet një shërbim civil cilësor në frymën profesionale duke zbatuar legjislacionin për shërbimin civil që Kosova të ketë një administratë efikase me vlera dhe standarde evropiane.

Fondet e Këshillit sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.

### III. PJESA E PËRGJITHSHME

Një shërbim civil i pavarur, profesional dhe i qëndrueshëm, është garanci e fuqishme e funksionimit të shtetit, pavarësisht rrethanave dhe situatave të ndryshme.

Më qëllim, që Republika e Kosovës të ketë një shërbim civil efikas, të paanshëm e i bazuar në merita dhe që pasqyron diverzitetin e popullit të Kosovës, Këshilli gjatë kryerjes së funksioneve të tij për periudhën raportuese, përmes shqyrtimit të ankesave të nëpunësve civil dhe aplikuesve për punësim në shërbim civil, mbikëqyrjen e respektimit të ligjit dhe parimeve udhëheqëse në shërbimin civil si dhe vëzhgimin e zgjedhjes së nëpunësve të nivelit drejtues apo nivelit të njëjtë ka konstatuar se në shërbimin civil ka një progres, por ende nuk është arritur profesionalizmi i duhur, paanshmëria, përgjegjshmëria, respektimi i kodit etik si dhe zbatimi i procedurave dhe ligjit.

Nga shqyrtimi i ankesave të nëpunësve civil dhe aplikuesve konstatohet se nëpunësit civil nuk rekrutohen gjithëherë, sipas procedurave të ndershme dhe meritës, avancimi nuk bëhet, sipas meritës dhe procedurave, vlerësimet e performancës vjetore nuk bëhen gjithëherë në mënyrë objektive, kontratat e punës (shkresë emërimi) nuk lëshohen dhe përtërihen me kohëzgjatje në pajtim me ligjin. Disa nga zyrtarët e lartë përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Këshillit kanë treguar neglizhencë dhe papërgjegjësi në zbatimin e vendimeve ligjore, gjë që në pajtim me nenin 15 paragrafi 1 dhe paragrafi 5 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin, Këshilli në mënyrë të rregullt, ka njoftuar më shkrim Kryeministrin dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, Këshilli në mënyrë të rregullt ka njoftuar Kuvendin e Kosovës lidhur me mos zbatimin e vendimeve të Këshillit për secilin institucion veç e veç.

Nga mbikëqyrja e institucioneve për respektim të ligjit është konstatuar se ende jo të gjitha institucionet kanë dosjet e personelit në nivelin e standardeve, përshkrimet e punës të standardizuara, komisione disiplinore dhe të ankesave që zbatojnë parimet që shpesh bëhen instrumente me ndikim dhe nën presion në vendimmarrje, menaxherëve të personelit nuk iu është dhënë roli dhe përgjegjësia që duhet t'a kenë sipas ligjit. Institucionet të cilave u janë dërguar rekomandime kanë treguar neglizhencë dhe papërgjegjësi në zbatimin e tyre, por edhe njoftimin mbi zbatimin e tyre.

Nga vëzhgimet për zgjedhjen e drejtorëve të departamenteve dhe nivelit të njëjtët është një përmirësim i dukshëm me kontributin e veçantë të Këshillit, duke mos lejuar përzgjedhjen përfundimtare pa u plotësuar kushtet ligjore për procedim, qoftë rreth konkursit, nivelit dhe përbërjes së komisioneve duke konstatuar se me qenë se anëtar të komisioneve janë niveli i Sekretarëve Permanent, Kryeshefave ekzekutiv dhe drejtorëve të institucioneve të veçanta, është brengosëse se pothuajse të gjithë janë ushtrues detyre.

#### IV. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I KËSHILLIT

Organizimi i brendshëm i Këshillit, është i rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe më anë të Rregullores së brendshme mbi organizimin e tij, në të cilën janë përcaktuar në mënyrë të detajuar përgjegjësitë e anëtarëve të Këshillit si dhe çdo zyrtari të punësuar në Sekretariatit e Këshillit.

**KËSHILLI** përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Anëtarët e Këshillit zgjidhen përmes konkursit të hapur dhe transparent te cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Kryetari i Këshillit zgjidhet nga vetë anëtarët e Këshillit. Mandati i të gjithë anëtarëve të Këshillit është 5 vjeçar.

**SEKRETARIATI** i Këshillit, është organ që ndihmon Këshillin në realizimin e funksioneve dhe detyrave të tij dhe përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv dhe dy departamente. Aktualisht në Sekretariatit e Këshillit janë të angazhuar 16 të punësuar në cilësinë e nëpunësve civil.

- Drejtori Ekzekutiv;
- Departamenti i Ankesave, Monitorimit dhe Vëzhgimit (8 nëpunës);
- Departamenti i Administratës dhe Personelit (7 nëpunës);

Kapitujt në vijim paraqesin një tablo të plotë të mënyrës së ushtrimit të funksioneve nga ana e Këshillit si dhe aktivitetet e kryera nga Këshilli gjatë periudhës një vjeçare të raportimit, 1 Janar - 31 Dhjetor 2010.

#### V. FUNKSIONET E KËSHILLIT

Në pajtim me nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-192, Këshilli ka këto funksione:

1. Funksioni i shqyrtimit të ankesave, shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë dhe aplikuesve punësim në shërbimin civil kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës
2. Funksioni i Mbikëqyrjes, mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil

3. Funksioni i vëzhgimit, vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës.

## VI. FUNKSIONI I ANKESAVE

Gjatë vitit 2010, në Këshill kanë arritur gjithsejtë 290 ankesa, te parashtruara nga nëpunësit civil dhe aplikuesit për punësim në Shërbim Civil të Kosovës.

Në mënyrë që të specifikohen më saktësisht llojet e ankesave, Këshilli në këtë raport ka ndarë ankesat në tri kategori:

- a) **objektit** të ankesave,
- b) strukturës **gjinore** dhe
- c) strukturës **nacionale**

### a) Ankesat e arritura sipas objektit:

Baza e ankimit të nëpunësve civilë që ankohen në Këshill, është e ndryshme. Gjatë vitit 2010 shumica e ankesave, kanë pasur për objekt, ndërprerjen e kontratës së punës, kontestimin e konkurseve, kompenzim material, mos vazhdimin e kontratës së punës, ulje të pozitës, ndërrim pozite dhe masa tjera disiplinore si suspendim nga puna, mos ngritje e koficientit etj. Nga kjo del se numri më i madh i ankesave ka të bëjë me:

1. Ndërprerje të kontratës së punës.....	86 ankesa ose 29.65 %
2. Kontestimi konkursi .....	82 ankesa ose 28.27 %
3. Kompensim material .....	45 ankesa ose 15.51 %
4. Mosvazhdim i kontratës së punës .....	26 ankesa ose 8.96 %
5. Ulje të pozitës .....	23 ankesa ose 7.93 %
6. Ndërrim pozite .....	5 ankesa ose 1.72 %
7. Masa tjera disiplinore; suspendim, mos ngritje e koeficienti etj....	23 ankesa ose 7.93 %





Fig 1. Tregon përqindjen e ankesave të arritura sipas objektit

**b) Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore të ankuesve:**


Duke ju referuar numrit të përgjithshëm të ankuesve prej **290** ankesave të arritura në vitin 2010, në bazë të gjinisë dhe grupeve të cilët iu janë drejtuar Këshillit, del se numri më i madh i ankuesve janë meshkuj dhe atë prej **226**, ose **77.93 %** ndërkaj femra janë **63** ankuese ose **21.72 %**. Ndërkaj një (**1**) ankesë është ushtruar nga Organi i Punësimit. Nga numri i përgjithshëm prej **290** ankesave, nëse ndahet në përqindje në formë grafikoni duket kështu:






**Fig 2. Tregon përqindjen e ankuesve sipas strukturës gjinore****c) Ankesat e ushtruara sipas strukturës nacionale:**

Strukturës nacionale e ankuesve që janë drejtuar Këshillit është: shqiptarë me 268, ankesa ose 92.41 %, serb 19 ankues ose 6.55 %, turq 1 ose 0.34 %, boshnjak 1 ose 0.34 % dhe të tjerë 1 ose 0.34 %. Ky numër i përgjithshëm i ankuesve prej 290 sish nëse ndahet në baza nacionale në formë grafikoni duket kështu:

**Fig 3.: Tregon përqindjen e ankuesve sipas strukturës nacionale****d) Ankesat e ushtruara kundër vendimeve të organeve të punësimit**

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka pranuar nga administrata lokale (komunat) 173 ankesa ose 59.65%, institucionet e administratës qendrore 54 ankesa ose 18.62% dhe Agjencitë e pavarura ekzekutive 63 ankesa ose 21.72 %. Këto të dhëna të paraqitura në mënyrë grafike duken kështu:

Fig. 4 Tregon përqindjen e ankesave ndaj vendimeve të autoriteteve punëdhënëse



## VII. ANKESAT E PARAQITURA NË KËSHILLI GJATË VITIT 2010

### 1. Ankesat sipas objektit dhe institucioneve

Këshilli gjatë, shqyrtimit të zgjedhjes së ankesave, ka konstatuar se shumica e ankesave të parashtruara nga nëpunësit civil dhe aplikuesve për punësim në shërbimin civil janë nga:

- a) Administrata Lokale (komunat),
- b) Administrata Qendrore (ministritë) dhe
- c) Agjencitë të pavarura dhe institucionet tjera.

#### a) Administrata Lokale (komunat)

Nëpunësit civil dhe aplikuesit për punësim në shërbimin civil nga administrata lokale gjatë vitit 2010 kanë ushtruar 173 ankesa me objekt ankese; ndërprerje e marrëdhënies së punës, kontestim konkursi, kompensim material, mos vazhdim i kontratës së punës, ulje në pozitë etj.



Tabela e mëposhtme pasqyron te dhënat mbi numrin dhe përqindjen e ankesave të arritura në Këshill gjatë vitit 2010, sipas Komunave.

<b>Nr.</b>	<b>Komunat</b>	<b>Nr. i ankesave</b>	<b>Përqindja</b>
1	Kamenicë	32	11.03%
2	Prishtinë	17	5.86%
3	Gjilan	16	5.51%
4	Prizren	11	3.79%
5	Podujevë	8	2.75%
6	Ferizaj	7	2.41%
7	Viti	7	2.41%
8	Mitrovicë	7	2.41%
9	Lipjan	6	2.06%
10	Kaçanik	6	2.06%
11	Vushtrri	6	2.06%
12	Rahovec	6	2.06%
13	Skenderaj	5	1.72%
14	Malishevë	4	1.37%
15	Suharekë	4	1.37%
16	Gjakovë	4	1.37%
17	Shtërpcë	4	1.37%
18	Graçanicë	4	1.37%
19	Klinë	3	1.03%
20	Drenas	3	1.03%
21	Istog	3	1.03%
22	Klllokot	3	1.03%
23	Deçan	2	0.68%
24	Hani i Elezit	2	0.68%
25	Junik	2	0.68%
26	Obiliq	1	0.34%
	<b>Gjithsejtë</b>	<b>173</b>	<b>59.65%</b>

Tabela tregojnë numrin dhe përqindjen:

**Tabela tregon: organin e punësimit, numrin e ankesave, objektin e ankimit**

Autoritet punëdhënëse KOMUNAT	Ndërprerje kontratës së punës	Mos vazhdim kontrate	Kontestim Konkursi	Kompensim material	Uljë në pozitë	Suspendim nga Puna	Masa disiplinore	Ndrrimit i vendit të punës	Të tjera	Gjithësejt
Prishtinë	8		2	4					3	17
Gjilan		1	9	4	1			1		16
Prizren	1	2	3	1					4	11
Skenderaj			1	2	1				1	5
Ferizaj		1	6							7
Lipjan	6									6
Malishevë	1	1	2							4
Kamenicë	23	2	1	2	3			1		32
Vushtrri		3	2		1					6
Suharekë	1		3							4
Kaçanik	2	1	1	1	1					6
Klinë	1	1		1						3
Pejë										
Viti	1	1	3	2						7
Drenas		1	1		1					3
Obiliq				1						1
Istog			1	2						3
Gjakovë		1	2	1						4
Mitrovicë			5	2						7
Podujevë	1	1		6						8
Shtime										
Deçan					2					2
Kllokot			3							3
Hani i Elezit			2							2
Rahovec	3								3	6
Shtërpcë	2	1	1							4
Junik	2									2
F. Kosovë										
Dragash										
Novo Bërdë										
Graçanicë		3	1							4
Leposaviç										
Mamushë										
Partesh										
Zubin Potok										
Zveçan										
<b>Gjithsej</b>	<b>52</b>	<b>20</b>	<b>49</b>	<b>29</b>	<b>10</b>			<b>2</b>	<b>11</b>	<b>173</b>



**Tabela II: Ankesat e arritura në Këshill, nga nëpunësit civil të administratës lokale (komunave)**

**b). Administrata qendërore (ministrinë)**


Nëpunës civil dhe aplikuesit për punësim në shërbimin civil nga administrata qendërore gjatë vitit 2010 kanë ushtruar 54 ankesa me objekt ankesë: ndërprerje e marrëdhënies së punës, kontestim konkursi, kompensim material, mos vazhdim i kontratës së punës, ulje në pozitë etj.

Nr.	Ministritë	Nr. i ankesave	Përqindja
1	Ministria e Drejtësisë	11	3.79%
2	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	8	2.75%
3	Ministria e Punëve të Brendshme	7	2.41%
4	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	7	2.41%
5	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	5	1.72%
6	Ministria e Bujqësisë	4	1.37%
7	Ministria e Transportit Poste-Telekomunikacionit	3	1.03%
8	Ministria e Administratës Publike	2	0.68%
9	Ministria e Shëndetësisë	2	0.68%
10	Ministria e Energjisë dhe Minierave	1	0.34%
11	Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve	1	0.34%
12	Ministria e Kulturës Rinis dhe Sporteve	1	0.34%
13	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	1	0.34%
14	Zyra e Kryeministrit	1	0.34%
	<b>Gjithsejtë</b>	<b>54</b>	<b>18.54%</b>

Tabela e mëposhtme pasqyron numrin e ankesave të ushtruara sipas objektit të ankesës dhe institucioneve:

Ankesat e arritura Autoritetet punëdhënëse MINISTRITË	Ndërprerje kontratës së punës	Mos vazhdim kontrate	Kontestim Konkursi	Kompensim material	Ulje në pozitë	Suspendim nga Puna	Të tjera	Gjithsej
MAP	1		1					2
MD	2		6		2		1	11
MASHT	2		1	2				5
MSH	2							2
MPMS			2	2			4	8
MMPH								0
MEM	1							1
MPB	1		5		1			7
MKK	1							1
MTI			3	1	2		1	7
MKRS		1						1
MBPZHR	2			1		1	2	4
MTPT	1		1	1				3
Admin. e Presidencës	0	0	0	0	0	0	0	0
ZKM			1					1
MEF	0	0	0	0	1	0	0	1
MFSK	0	0	0	0	0	0	0	0
MAPL	0	0	0	0	0	0	0	0
MPJ	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>13</b>	<b>1</b>	<b>20</b>	<b>7</b>	<b>6</b>	<b>1</b>	<b>6</b>	<b>54</b>

## Përqindja e ankesave të ushtruara ndaj Administratës qendrore (ministrinë)



## c) Agjencitë e pavarura dhe institucionet tjera

Nëpunës civil dhe aplikuesit për punësim në shërbimin civil nga Agjencitë e pavarura dhe institucionet tjera, gjatë vitit 2010 kanë ushtruar 63 ankesa me objekt ankesë: ndërprerje e kontratës së punës, kontestim konkursi, kompensim material, ulje në pozitë, mos vazhdim i kontratës së punës etj.

Tabela e mëposhtme pasqyron numrin e ankesave të arritura në Këshill gjatë vitit 2010 sipas institucionit dhe objektit të ankimit.

Autoritete punëdhënëse AGJENCIT e PAVARURA	Ndërprerje kontratës së punës	Mos vazhdim kontrate	Kontestim Konkursi	Kompensim material	Degradim nga Pozita	Suspendim nga Puna	Masa disiplinore	Ndërrimi i vendit të punës	Të tjera	Gjithsejt
QKUK	8		9		3					20
Agjencia për Produkte dhe Pajisje Medicinale	1									1
ATK	3			2		1				6
TMK				1					1	2
IAP					1					1
QIF	2									2
APK	1					1				2
ESK				1				2		3
KQZ	2						2			4
Agjencioni i privatizimit të pronave				1	1					2
ART		1								1
AKK	1									1
AUV	1									1

### Qendrat e Mjekësisë Familjare

Qendra e Mjekësisë Familjare Ferizaj					1					1
Qendra e Mjekësisë Familjare Gjilan					1					1
Qendra e Mjekësisë Familjare Prishtinë	1									1
Qendra e Mjekësisë Familjare Kamenicë	1							1		2
Qendra e Mjekësisë Familjare Dragash			1							1
Qendra e Mjekësisë Familjare Lipjan		1								1
Qendra e Mjekësisë Familjare Graçanicë										
Spitali i Mitrovicës					1					1



## Institucionet të tjera

KRPP				3						3
Gjykata Kushtetuese		1	1							2
IKSHPK		1								1
Këshilli Gjyqësor i Kosovës		1	1	1						3
Akad. e Shkencave (ASHAK)			1							1
<b>Gjithsej</b>	<b>21</b>	<b>5</b>	<b>13</b>	<b>9</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>63</b>

Të dhënat e mëposhtme tregojnë numrin dhe përqindjen e ankesave të arritura kundër Agjencioneve të Pavarura, QKMF-ve dhe institucioneve tjera:



Nr.	Agjencionet e Pavarura	Nr. i ankesave	Përqindja
1.	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	20	6.89%
2.	Agjencia për produkte medicinale	1	0.34%
3.	Administrata Tatimore të Kosovës	6	2.06%
4.	Komisioni Qendror Zgjedhor	4	1.37%
5.	Agjencioni i Pyjeve të Kosovës	2	0.68%
6.	Enti Statistikor i Kosovës	3	1.03%
7.	Trupat Mbrojtëse të Kosovës	2	0.68%
8.	Qendra e Inteligjencës Financiare	2	0.68%
9.	Agjencioni i Privatizimit të Pronave	2	0.68%
10.	ART	1	0.34%
11.	Instituti Kosovar i Administratës Publike	1	0.34%
12.	AKK	1	0.34%
13.	Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë	1	0.34%


### QKMF

14.	QKMF-Mitrovicë	1	0.34%
15.	QKMF-Prishtinë	1	0.34%
16.	QKMF-Ferizaj	1	0.34%
17.	QKMF-Dragash	1	0.34%
18.	QKMF-Gjilan	1	0.34%
19.	QKMF-Kamenicë	2	0.68%
20.	QKMF-Lipjan	1	0.34%
21.	QKMF - Graçanicë	1	0.34%

### Institucionet tjera

22.	KRPP	3	1.03%
23.	Gjykata Kushtetuese	2	0.68%
24.	IKSHPK	1	0.34%
25.	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	3	1.03%
26.	Akad. e Shkencave	1	0.34%





## VIII ANKESAT E SHQYRTUARA GJATË VITIT 2010

Këshilli në vitin 2010 ka pranuar 290 ankesa, ndërsa ka shqyrtuar dhe vendosur 384 ankesa që do të thotë 94 ankesa më shumë të mbetura nga vitet paraprake.

Kolegjet e Këshillit, në pajtim me bazën ligjore kanë vendosur ankesat përmes seancave për këshillim – votimit dhe seancave dëgjimore.

Nga të dhënat e mëposhtme shihet, se Këshilli ka pasur të bëjë me vendosjen e ankesave të ushtruara nga nëpunësit civil dhe aplikuesit për punësim në shërbimin civil kundër vendimeve që kanë të bëjnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil të:

1. Ministrive (administrata qendrore),
2. Komunave (administrata lokale) dhe
3. Agjencive të pavarura dhe institucioneve të tjera.

### 1) Ministrive (administrata qendrore)

Këshilli ka vendosur 71 ankesa, 54 ankesa të pranuar në vitin 2010 dhe 17 prej tyre të bartura nga vitet paraprake.

Shih të dhënat tabelore në vijim:

Ankesat e Shqyrtuara 2010	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Pjesërisht të Aprovuara	Të Hedhura poshtë	Të Pezulluara	Rishqyrtim Ex-Officio	Shpallen Jo Kompetent	Përfundon Procedura	Tërheqje të Ankesës	Nr. ankesave të Shqyrtuara	Të Ekzekutuara	Të Pa ekzekutuara
MAP	1	1		1				1		4	-	1
MD	2	8		1		1	1	1		14	3	-
MASHT		2		2			1	1		6	-	-
MPMS	7	3						1		11	6	1
MMPH	1									1	-	1
MEM												
MPB	1	7		2						10	1	-
MKK		1		1						2		
MTI	4	1				1				6	3	2
MKRS	2									2	1	1
MBPZHR	2	3		1						6	2	-
MTPT		1		1						2		
MEF	1									1	1	
MAPL												
MSH	3			1			1			5	1	2
ZKM		1								1		
MFSK												
KUVENDI												
PRESIDENCA												
<b>GJITHSEJ</b>	<b>24</b>	<b>28</b>		<b>10</b>		<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>		<b>71</b>	<b>18</b>	<b>8</b>

Tabela IV: Ankesat e shqyrtuara të vitit 2010 ndaj ministrive

## 2. Komunave (administrata lokale)

Këshilli ka vendosur 241 ankesa, 173 ankesa të pranuar në vitin 2010 dhe 68 prej tyre të bartura nga vitet paraprake.

Shih të dhënat tabelare në vijim:

Ankesat e Shqyrtuara 2010 KOMUNA	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Pjesërisht të Aprovuara	Të Hedhura poshtë	Të Pezulluara	Rishqyrtim Ex-Offisio	Shpallen Jo Kompetent	Përfundon Procedura	Tërheqje të Ankeses	Nr. ankesave të Shqyrtuara	Të Ekzekutuara	Të Pa Ekzekutuara
KK. Prishtinë	9	11	1	6	1		1	1		27	2	8
KK. Gjilan	10	5	1				3	1		20	6	5
KK. Prizren	3	5	1	1			2			12	1	4
KK. Skenderaj	3	5		1		1		1		11	3	1
KK. Ferizaj		12	1							13	1	-
KK. Lipjan	6	1		1						8	6	-
KK. Malishevë	2	2				1	1	1		7	1	2
KK. Kamenicë	8	18		1		1	6			34	7	2
KK. Vushtrri	4	2	1				1	1		9	4	1
KK. Suharekë		4	1				2		1	8	1	-
KK. Kaçanik	4	1					1			6	-	4
KK. Klinë	2	1								3	-	2
KK. Pejë		1		1						2	-	-
KK. Viti		5	1	2			1	1		10	-	-
KK. Drenas		2				2				4	1	1
KK. Obiliq	2	1		1						4	1	1
KK. Istog	2	1						1		4	2	-
KK. Gjakovë	1	3		2			1	1		8	-	1
KK. Mitrovicë	3	1	5	2			2			13	4	4
KK. Podujevë	7	2				1		1		11	7	-
KK. Shtime	1	1								2	1	-
KK. Deçan	2					1				3	1	2
KK. Klllokot	3									3	2	1
KK. Hani Elezit	1									1	1	-
KK. Rahovec		1				1	1			3	-	1
KK. Shtërpçë		6			1	1	1			9	-	1
KK. Junik	2									2	-	2
KK. Graçanicë							4			4	-	-
KK. F.Kosovë											-	-
KK. Novobërd											-	-
KK. Dragash											-	-
KK. Leposaviq											-	-
KK. Mamushë											-	-
KK. Partesh											-	-
KK. Zubin Potok											-	-
KK. Zveqan											-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>72</b>	<b>91</b>	<b>12</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>9</b>	<b>27</b>	<b>9</b>	<b>1</b>	<b>241</b>	<b>52</b>	<b>42</b>

Tabela v: Ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2010 ndaj komunave

### 3. Agjencive të pavarura dhe institucioneve të tjera

Këshilli ka vendosur 72 ankesa, 63 ankesa të pranuar në vitin 2010 dhe 9 prej tyre të bartura nga vitet paraprake.

Shih të dhënat tabelare në vijim:

**Tabela VI: Ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2010 kundër agjencive dhe institucioneve të pavarura**

Ankesat e shqyrtuara në vitin 2010	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Pjesërisht të Aprovuara	Të Hedhura poshtë	Të Pezulluara	Rishqyrtim Ex-Officio	Shpallen Jo Kompetent	Përfundon Procedura	Tërheqje të Ankeses	Nr. ankesave të Shqyrtuara	Të Ekzekutuara	Të Pa Ekzekutuara
QKUK	8	1				8	3	1		21	14	2
KGJK		1		1						2	-	-
AKPM	1									1	1	-
ATK	1	3			2					6	1	-
TMK		2		1			1			4	-	-
IAP		2	1							3	1	-
QIF	1					1				2	-	2
APK	2									2	-	2
ESK						1				1	-	1
KQZ	1	2	1							4	2	-

Spitali Vushtrri				1						1	-	-
Spitali Prizren				1						1	-	-
Spitali Mitrovicë			1							1	-	1
Spitali Gjilan	1							1		2	1	-
QKMF Prishtinë				2				1		3	-	-
QKMF Gjilan		1		1						2	-	-
QKMF Ferizaj	1									1	1	-
QKMF Kamenicë		1								1	-	-
QKMF Dragash		1								1	-	-

QKMF Lipjan				1						1	-	-
QKMF Junik				1						1	-	-
QKMF Malishevë	1									1	-	1
QKMF Drenas		1								1	-	-
QKMF Prizren		1								1	-	-
QKMF Skenderaj											-	-

Gjykata Kushtetuese		2								2	-	-
Qendra e Paraburgimit Pejë							1			1	-	-
IKSHPK		1								1	-	-
ART	1			1						2	-	1
Akad. Shkencave (ASHAK)	1									1	-	1
Gjykata Supreme	1									1	-	1
<b>Gjithsej</b>	<b>20</b>	<b>19</b>	<b>3</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>10</b>	<b>5</b>	<b>3</b>		<b>72</b>	<b>21</b>	<b>12</b>

## IX. ANKESAT E ZGJIDHURA GJATË VITIT 2010 DHE MËNYRA E ZGJEDHJES SE TYRE.

### 1. Ankesat e zgjidhura

Këshilli gjatë vitit 2010 ka **shqyrtuar dhe vendosur gjithsejtë 384 ankesa**, duke përfshirë edhe me ankesat nga vitet paraprake.

Tabela në vijim pasqyron të dhënat mbi ankesat e zgjidhura sipas viteve, mënyrës së vendosjes dhe ekzekutimin apo mos ekzekutimin e tyre:

Ankesat sipas viteve	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë	Terheqje dhe shp. jo kompetent.	Përfundim	Ex Officio	Të pezulluara	Totali	Të ekzekutuara	Të pa ekzekutuara
2010	87	88	5	24	36	3	18	3	263	74	49
2009	21	45	9	13		3	3	1	95	13	9
Të viteve tjera	8	6	1	1		10			26	4	3
<b>Gjithsej</b>	<b>116</b>	<b>139</b>	<b>15</b>	<b>38</b>	<b>36</b>	<b>16</b>	<b>21</b>	<b>4</b>	<b>384</b>	<b>91</b>	<b>61</b>

Tabela përmbledhëse mbi ankesat e zgjedhura në bazë të viteve

## Mënyra e zgjidhjes së ankesave

Mënyra e zgjidhjes së ankesave reflekton ndarjen e tyre në të: aprovuara, pjesërisht të aprovuara, të refuzuara, të hedhura poshtë, përfundim procedure, ex-officio dhe të pezulluara.

### Të aprovuara

Janë ankesat e paraqitura nga nëpunësit civil apo aplikuesit për punësim që në bazë të provave argumenteve dhe fakteve është anuluar vendimi i organit punëdhënës, dhe njëherit është obliguar për ekzekutimin e vendimeve të Këshillit. Numri i ankesave të aprovuara gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ankesat e arritura gjatë viteve paraprake është 116.

### Pjesërisht të aprovuara

Janë ankesat të cilat kanë dy e më shumë pretendime ankimore dhe kur ankesa nuk aprovohet në tërësi. Kjo ndodhë në rastet kur organi punëdhënës obligohet që të përmbushë ndonjërin nga obligimet procedurale si psh: rishpallje konkursi publik ose pjesërisht aprovohen pretendimet ankimore. Numri i ankesave të pjesërisht të aprovuara gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ato të arritura gjatë viteve paraprake është 15 ankesa.

### Të refuzuara

Janë ankesat e paraqitura nga nëpunësit civil të cilat në bazë të provave argumenteve dhe fakteve të paraqitura nga organi punëdhënës refuzohen si të pa bazuara. Numri i ankesave të refuzuara gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ato të arritura gjatë viteve paraprake është 139.

### Të hedhura poshtë

Janë ankesat të cilat pranohen dhe shqyrtohen nga ana e Kolegjeve të Këshillit por që hedhen poshtë kur kemi të bëjmë me ankesat të paraqitura jashtë afatit ligjor, mosplotësimin të ankesës në afatin ligjor nga ankuesi. Numri i ankesave të hedhura poshtë gjatë periudhës raportuese është 38.

### Të tërhequra dhe të shpallura Jo Kompetent

Janë ankesat të cilat gjatë shqyrtimit të tyre nga Kolegjet e Këshillit konstatohet se për ankesat të cekura Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ato. Lidhur me ankesat e tilla këshilli ka konstatuar jo kompetencën e vete për 36 sish.

### Ex-officio

Janë vendime të cilat, sipas detyrës zyrtare Këshilli i obligon organet e punësimit për të ndërmarr veprime procedurale dhe pastaj për të vendosur ankesën, sipas objektit të ankimit nga Këshilli. Numri i ankesave të vendosura ex-officio gjatë



periudhës raportuese, por që reflekton edhe ato të arritura gjatë viteve paraprake është 21.

### Përfundim Procedimi

Janë ankesat e nëpunësve civil dhe aplikuesve për të cilat përfundon procedimi administrativ për shkak të tërheqjes së ankesës, eliminimit të arsyes për ankimin, ose për shkak të braktisjes së ankesës nga ana e ankuesit kur ankuesi nuk ka qenë i interesuar dhe jo aktiv mbi tre muaj dhe kur konstatohet se objekti për të cilin është filluar procedimi ka humbur. Numri i ankesave me përfundim procedimi gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ato të arritura gjatë viteve paraprake është 16 sish.

### Të pezulluara

Janë ankesat e nëpunësve civil që për marrjen e vendimit përfundimtar në procedurë administrative duhet të pritet në vendim paraprak të një organi kompetentë apo vendimin e gjykatës. Numri i ankesave të pezulluara gjatë periudhës raportuese, por që reflekton edhe ato të arritura gjatë viteve paraprake është 4.

Nga numri i tërësishëm i ankesave të zgjidhura në vitin 2010 nga Këshilli janë të aprovuara 116 ankesa ose 30.2%, pjesërisht të aprovuara 15 ankesa ose 3.90 %, të refuzuara 139 ankesa ose 35.9%, të hedhura poshtë 38 ankesa ose 10%, me përfundim procedure 16 ankesa ose 4.16 %, ex officio 21 ankesa ose 5.4% dhe janë pezulluar 4 ankesa ose 1.04%.




Fig. 8 Tregon përqindjen e ankesave sipas mënyrës së vendosjes në vitin 2010

## Ankesat e aprovuara, pjesërisht të aprovuara, ex-officio dhe ekzekutimi i tyre

Ankesa të aprovuara, pjesërisht të aprovuara dhe ex officio në vitin 2010, të cilat nuk janë ekzekutuar nga ana e organeve të punësimit janë si në vijim: të aprovuara 116 ankesa, pjesërisht të aprovuara 15 ankesa, ex-officio 21 ankesa, prej të gjitha ankesave, janë ekzekutuar 91 vendime dhe nuk janë ekzekutuar 61 vendime.

## X. ZBATIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT NGA ORGANET PUNËNËSIMIT

Vendimet e Këshillit janë të obligueshme që të zbatohen nga organet punëdhënëse në Shërbimin Civil të Kosovës, meqë në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Mosekzekutimi i tyre nga personat përgjegjës, konsiderohet cenim i të drejtave nga marrëdhënia e punës të nëpunësit të shërbimit civil, apo aplikuesit për punësim në shërbimin civil të Kosovës. Sipas nenit 13 të Ligjit për Këshillin përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Këshillit janë: Sekretarët e përgjithshëm të Ministrive, Kryeshefat ekzekutiv të Agjencive dhe Institucioneve të Pavarura, kryetarët e komunave dhe përgjegjësit kryesor të organit përkatës të punësimit.

Përkundër këtij fakti që vendimet e Këshillit janë të formës së prerë në procedurë administrative siç shihet në tabelat e më sipërme prej **152** ankesave të aprovuara, pjesërisht të aprovuara dhe ex-officio organet punëdhënëse i kanë zbatuar **91** vendime, ndërsa nuk janë zbatuar **61** vendime të tij.

Në pajtim me nenin 15 parag. 5 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin, pas njoftimit nga ankuesi për mos zbatimin e vendimit në afatin e përcaktuar ligjor, Këshilli në mënyrë të rregullt ka njoftuar Kuvendin e Kosovës lidhur me mos ekzekutimin e vendimeve të Këshillit për secilin institucion veç e veç.

Nga të dhënat e Sekretariatit të Këshillit, konstatohet se lidhur me vendimet e ekzekutuara dhe pa ekzekutuara, gjendja është si në tabelat e mëposhtme:




Fig. 9 Tregon përqindjen e vendimeve të ekzekutuara dhe të pa ekzekutuara .

**Vendimet e pa ekzekutuara sipas institucionit janë si në vijim:**

Ministritë	Nr. i vendimeve të pa ekzekutuara	Komunat	Nr. i vendimeve të pa ekzekutuara	Agjencitë dhe institucionet tjera të pavarura	Nr. i vendimeve të pa ekzekutuara
MAP	1	KK. Prishtinë	8	QKUK	2
MPMS	1	KK. Gjilan	5	QIF	2
MMPH	1	KK. Prizren	4	APK	2
MTI	2	KK. Skenderaj	1	ESK	1
MKRS	1	KK. Malishevë	2	Spitali i Mitrovicës	1
MSH	2	KK. Kamenicë	2	QKMF-Malishevë	1
		KK. Vushtri	1	ART	1
		KK. Kaçanik	3	ASHAK	1
		KK. Klinë	2	Gjykata Supreme	1
		K.K.Drenas	1		
		KK. Obiliq	1		
		K.K.Gjakovë	1		
		KK. Mitrovicë	4		
		KK. Deçan	2		
		K.K.Kllokot	1		
		KK. Rahovec	1		
		K.K.Shtërpçë	1		
		K.K.Junik	1		
<b>GJITHSEJT</b>	<b>8</b>		<b>41</b>		<b>12</b>

## XI. FUNKSIONI I MBIKËQYRJES

### Vlerësimi i respektimit të ligjit

Këshilli e ushtron funksionin e mbikëqyrjes në bazë të nenit 10 paragrafi 3 dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L 192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, duke u bazuar në parimet e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli këtë funksion e ushtron, për të siguruar që autoritetet punëdhënëse të zbatojnë ligjin e shërbimit civil të Kosovës dhe aktet nënligjore, të cilat rregullojnë çështjet e menazhimit, organizimin e përgjithshëm të një shërbimi civil të paanshëm politikisht, rregullat dhe pranimet në të, kushtet e punës, të drejtat dhe detyrimet, sjelljen personale, avancimi në karrierë, si dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civil e shërbyesve civil si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal.

Këshilli gjatë vitit 2010 ka realizuar 59 vizita në institucione qendrore dhe lokale duke pasur parasysh se Ligji për Shërbimin Civil të Kosovës ka hyrë në fuqi me 11 korrik 2010, Këshilli lidhur me zbatimin e legjislacionit të ri për shërbimin civil ka dhënë këto rekomandime.

## FUSHAT E MBIKËQYRJES NË SHËRBIMIN CIVIL

### *Menaxhimi i personelit*

Shumica e institucioneve si qendrore ashtu edhe ato lokale nuk kanë zbatuar plotësisht obligimin ligjor që menaxheri apo udhëheqësi i personelit të ketë rolin, përgjegjësitë dhe autorizimet që i takojnë me ligj dhe në disa raste nuk kanë fare menaxher të personelit. Në kuptim të respektimit të këtij kriteri Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat i obligon të gjitha institucionet në nivelin qendror dhe lokal që të bëjnë riorganizimin e njësive të personelit (burimeve njerëzore), konform nenit 7 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

### *Procedurat e rekrutimit*

Gjatë vizitave që Kolegjet e Këshillit kanë zhvilluar nëpër institucione të ndryshme kanë konstatuar se në disa institucione autorizimi i rekrutimit të nëpunësve civil nuk iniciohet dhe aprovohet në pajtim me procedurat, publikimi i konkurseve nuk bëhet gjithë herë në bazë të parimit të gjithë përfshirjes, komisionet e rekrutimit nuk janë në përbërje të nivelit për postin e publikuar, rekrutohen kandidat në kundërshtim me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të konkursit dhe parimit të meritës, me rastin e rishpallje së konkurseve shpesh ndryshohen kushtet e konkursit që do të thotë se i

përshtatën kandidatëve të caktuar që paraqet shkelje të parimeve udhëheqëse të shërbimit civil. Këshilli gjithashtu në kuptim të respektimit të LSHC ka nxjerr rekomandime me të cilat ka obliguar së në rast të plotësimit të ndonjë pozite të lirë të nivelit drejtues të veprohet konform nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe konform nenit 10 paragrafi 1.2 dhe nenit 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe të ftohet Këshilli që të marr pjesë si vëzhgues në procesin e intervistimit të kandidatëve dhe pas përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit të njoftohen të gjithë kandidatët që kanë marrë pjesë në intervistim apo testim dhe të drejtën për tu ankuar në fund të procedurës.

#### ***Procedura e kontratave***

Gjatë monitorimit Kolegjet e Këshillit kanë konstatuar po thuaj se të gjitha organet e punësimit nuk kanë filluar zëvendësimin e kontratave të punës më shkresë emërim në pajtim me nenin 96 dhe 97 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Shkak për mos zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil ka qenë paqartësitë e sponzoruesit të ligjit se a duhet të zbatohet ligji para se të nxirren edhe akte tjera nënligjore.

#### ***Procedura e kontesteve dhe ankesave***

Gjatë monitorimit Kolegjet e Këshillit kanë vërejtur se në disa organe e punësimit nuk kanë themeluar komisionin për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave dhe disa edhe nëse kanë themeluar përbërja e tyre nuk është në pajtim me ligjin. Ankesat shpesh nuk shqyrtohen fare brenda afatit ligjor dhe pas heshtjes administrative nëpunësit civil apo aplikuesit i drejtohen me ankesë Këshillit. Këshilli shpesh obligon ex-officio autoritetet punëdhënëse që të shqyrtojnë ankesën e nëpunësit apo aplikuesit, kështu që kjo shkakton vonesën për shqyrtim të ankesës nga ana e Kolegjeve të Këshillit për të nxjerr vendim meritore. Lidhur me këto konstatime Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat ka obliguar OP që të formohen komisionet disiplinore, konform nenit 81 dhe 82 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

#### ***Procedura disiplinore***

Gjatë monitorimit Kolegjet e Këshillit kanë vërejtur se disa OP nuk kanë themeluar komisionin disiplinor në pajtim me bazën ligjore në fuqi. Lidhur me përgjegjësinë disiplinore shpesh merren vendime arbitrare pa u proceduar përmes menaxherit të personelit dhe komisionit disiplinor. Në disa institucione nëpunësit civil nuk janë të njoftuar me Kodin e mirësjelljes për nëpunësit civil, që nënkupton edhe mungesën e informacioneve mbi konfliktin e interesit. Andaj me qellim të detyrimit të OP që ti respektojnë dispozitat ligjore të kësaj fushe Këshilli ka nxjerr rekomandime sipas të cilave

rekomandon OP që të formohen komisionet disiplinore konform nenit 70 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

### **Procedura e periudhës provuese**

Këshilli gjatë monitorimit ka vërejtur se disa OP nuk kanë plan të periudhës provuese dhe vlerësimi i përfundimit të periudhës provuese nuk bëhet në pajtim me procedurat dhe ligjin. Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat janë obliguar organet e punësimit, që të veprojnë sipas nenit 21 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në rast se nëpunësit civil në punë provuese të cilit nuk i konfirmohet në pozicionin e punës, mund të paraqes ankesë kundër këtij vendimi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, prej ditë së komunikimit të vendimit nga njësia e personelit. Në këtë rast njësiti e personelit nuk mund të fillojnë procedimin e procesit të rekrutimit të ri për atë vend të punës, derisa të shqyrtohet dhe të merret vendim në Këshill.

### **Procedura e ndërprerjes së marrëdhënies së punës**

Gjatë monitorimit Këshilli ka vërejtur se ndërprerja e marrëdhënies së punës në disa institucione është bërë në kundërshtim me procedurat dhe bazën ligjore. Duke u mbështetur në bazën ligjore në fuqi, ndërprerja e marrëdhënies së punës së nëpunësve civil bëhet vetëm me vendim të komisioneve disiplinore apo bazës së dorëheqjes me vullnetin e tij, pensionimin, vdekjes dhe skadimit të kontratës, por me kusht që vendi i punës shuhet dhe nuk pranohen punonjës të ri për vendin e caktuar të punës.

### **Procedura e përshkrimeve të punës**

Këshilli ka vërejtur se shumica e institucioneve ende nuk kanë standardizuar përshkrimet e punës, gjegjësisht rregulloret mbi sistematizimit e vendeve të punës, duke kaluar procedimin e rishikimit të tyre dhe aprovimit përfundimisht nga menaxherët e personelit. Ndaj me qëllim që të përmbushet edhe ky kusht në pajtim me dispozitat e Ligjit të Shërbimit Civil. Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat ka obliguar organet e punësimit që t'i përmbushin brenda afatit ligjor.

### **Procedura e vlerësimit të kryerjes së punëve**

Lidhur me këtë procedurë Këshilli ka vërejtur se jo të gjitha OP bëjnë vlerësimin e kryerjes së punëve për vitin kalendarik. Këshilli po ashtu ka vërejtur se ky vlerësim në disa raste është bënë në mënyrë fiktive, ndërsa gjatë vizitave në shumë raste kemi inkurajuar se vlerësimi duhet të bëhet në mënyrë objektive duke respektuar parimet e shërbimit civil dhe Këshilli ka rekomanduar që të behet vlerësimi vjetor i rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil, konform nenit 33 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

**Procedura mbi pushimet**

Këshilli ka vërejtur se procedura e të gjitha llojeve të pushimeve menaxhohet sipas procedurave, por është vërejtur se disa institucione kanë problem me lejimin e pushimeve mjekësore të stërzgjatura në shumicën e rasteve. Këshilli ka vërejtur se kjo ndodhë si rezultat i sëmundjeve të rënda.

**Procedura mbi orarin e punës dhe vijueshmërinë**

Gjatë kësaj periudhë raportuese Këshilli ka vërejtur se pothuajse në të gjitha institucionet menaxhohet vijueshmëria në punë dhe respektimi i orarit të punës. Me përjashtim disa organet punësimit të cilat akoma nuk kanë një mekanizëm të ndërtuar mbi të dhënat e ardhje-vajtjes nga puna për këtë arsye Këshilli ka nxjerr rekomandime me të cilat ka obliguar organet e punësimit që t'i plotësojë këtë kusht brenda afatit ligjor.

**Procedura mbi mundësitë e barabarta**

Këshilli ka vërejtur se disa institucione ende nuk kanë arritur të sigurojnë njësitë për të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta, siç dihet zyra për mundësi të barabarta duhet të inkurajojë punësimin e minoriteteve, të sigurojë barazinë gjinore, si dhe inkurajimin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, gjë që lidhur me këtë Këshilli ka nxjerr një rekomandime për përmbushjen e këtij obligimi.

**Dosjet personale**

Në disa raste Këshilli ka vërejtur se niveli i udhëheqjes, administrimit dhe mirëmbajtjes së dosjeve personale nuk përkon me standardet e kërkuara nga baza ligjore në fuqi. Në disa institucione është vërejtur se dosjet personale nuk mbahen në ambiente të sigurta, nuk janë të kompletuara me të dhënat personale dhe nuk freskohen në baza të rregullta për t'iu bashkangjitur ngritjen dhe zhvillimin profesional individual të nëpunësve civil. Për këtë mangësi Këshilli ka udhëzuar menaxheret e personelit që të përmirësojnë këto të meta, kurse përmbushja e tyre do konstatohet përmes vizitave monitoruese që do t'i bëjë Këshilli në vitin vijues.

**Trajnimet**

Këshilli gjatë monitorimit të institucioneve ka vërejtur se planifikimi, programi dhe strategjia e trajnimeve të nëpunësve civil nuk është në nivelin e nevojave për trajnim dhe zhvillimit profesional të personelit. Sa do që në sensin e aftësimin profesional Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) ka kryer një punë të mirë në trajnimin e stafit profesional në fushën e prokurimit dhe auditimit, por Këshilli ka vërejtur se mungojnë trajnimet më të avancuara gjithëpërfshirëse sidomos për njohuritë themelore mbi Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës dhe parimeve udhëheqëse në Shërbimin Civil.

Këshilli ka nxjerr një rekomandim unik për të gjitha organet e punësimit që të organizohen trajnime për ngritje profesionale për të gjithë nëpunësitë civil, konform nenit 35 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

## XII. FUNKSIONI I VËZHGIMIT

Këshilli ka funksionin e vëzhgimit, të procedurave për zgjedhjen e nëpunësve civil të nivelit drejtues në shërbimin civil të Kosovës (Drejtorëve të Departamenteve dhe nivelit të njëjtë).

Ky funksion është i paraparë me nenin 10 paragrafi 1.2 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin. Në pajtim me dispozitën e përmendur, organet e punësimit në Shërbimin Civil të Kosovës, janë të obliguara që të njoftojnë Këshillin, për kohën e mbajtjes së intervistës, për plotësimin e vendeve të punës së nëpunësve civil të nivelit drejtues, që Këshillit për vëzhgim duhet t'i paraqes tërë dokumentacionin e nevojshëm, lidhur me realizimin e konkursit për të cilin Këshilli është ftuar të marrë pjesë në vëzhgim.

Gjatë ushtrimit të këtij funksioni, Këshilli është i ndihmuar me dokumentacion të nevojshëm, vërteton se a janë plotësuar kushtet për mbajtjen e intervistës, duke kontrolluar dosjen complete të rekrutimit, për rastin konkret e sidomos kopjen e konkursit të shpallur, përbërjen e komisionit intervistues duke u kujdesur që ai ti ketë përmbushur kriteret e parapara me Ligjin për Shërbimin Civil, listën e kandidatëve që kanë konkurruar, mbarëvajtjen e intervistës dhe pas marrjes së raportit nga organi punësimit, për zgjedhjen e kandidatit, vendos nëse kjo procedurë ka qenë në përputhje me parimet udhëheqëse të Shërbimit Civil të Kosovës.

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të vëzhgimit Këshilli gjatë periudhës raportuese në organet e punësimit ka realizuar **53** vëzhgime të zgjedhjes së **43** të nëpunësve civil të nivelit drejtues.

Prej tyre si rekrutime të rregullta, Këshilli ka nxjerr 43 vendime për rekrutimin (zgjedhjen) e nëpunësve civil të nivelit drejtues, në disa vizita vëzhguese, Këshilli ka gjetur se institucionet përkatëse me rastin e rekrutimit kanë vepruar në kundërshtim me parimet dhe rregullat e shërbimit civil.

Këshilli me qëllim të evitimit të shkeljeve të konstatuara ka nxjerrë rekomandime me cilat ka obliguar organet e punësimit që t'i evitojnë shkeljet e konstatuara. Përkundër rezultateve të arritura në vëzhgim dhe përmirësimet e dukshme në zbatimin e procedurave ligjore dhe parimeve të shërbimit civil, disa institucione nuk kanë respektuar dispozitat ligjore lidhur me procedurat e rekrutimit rreth zgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit drejtues.



Ndonëse është obligim ligjor që me rastin e zgjedhjes së këtyre drejtorëve të marrin pjesë si vëzhgues antarët e Këshillit, ka institucione të cilat nuk e kanë respektuar bazën ligjore, dhe kanë bërë zgjedhjen e nënpunësve të nivelit drejtues, pa pjesëmarrjen e Këshillit, të kësaj natyre ka edhe raste për mos gatishmërinë për bashkëpunim me Këshillin nga ana e zyrtarëve të nivelit të lartë drejtues.

Këshilli gjate vitit 2010 ka vëzhguar dy procedura te avancimit në pajtim me Ligjin e Shërbimin Civil.

Institucionet të cilat Këshilli i ka vëzhguar në zgjedhjen e personelit të lartë përmendur janë:  
Shih Tabelën në vijim:

Institucionet	Nr i Posteve	Titulli i pozitave	Vërejtje
<b>Zyra e Kryeministrit</b>	1	-Drejtor i zyrës për planifikim Strategjik	
<b>Ministria e Bujqësisë</b>	2	- Drejtor i Institutit Bujqësor në Peje - Drejtor i Institutit Bujqësor të Kosovës	
<b>Ministria e Tregtisë dhe Industrisë</b>	3	- Drejtor i Departamentit të Tregtisë - Drejtor i Departamentit Ligjor - Drejtor i Departamentit të Tregtisë dhe Hotelërisë	
<b>Ministria e Ekonomisë dhe Financav</b>	2	- Drejtor i Departamentit te Tatimit ne Pronë - Drejtor i Departamentit të Teknologjisë Informative	
<b>Ministria për Komunitete dhe Kthim</b>	1	-Drejtor i zyrës Ligjore	
<b>Ministra e Drejtësisë</b>	3	- Drejtor i Departamentit të Mjekësisë Ligjore - Drejtor i Administratës dhe Personelit - Drejtor i Departamentit të Pranimit Ruajtjes dhe Vlerës së shitjes së Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar	
<b>Ministra e Administratës Publike</b>	3	- Drejtor i Zyrës së Prokurimit - Drejtor i Zyrës së Komunikimit - Drejtor i Departamentit të DASHC- së	
<b>Ministria e Punëve të Brendshme</b>	2	Drejtor i Departamentit për Personalizimin e Dokumenteve - Drejtor i Departamentit për Siguri Publike	
<b>Ministria e Arsimit</b>	2	- Drejtor i Departamentit të Zhvillimit Parauniversitar - Drejtor i Institutit Pedagogjik	
<b>Ministria e Kulturës</b>	3	- Drejtor i Departamentit të Kulturës - Drejtor i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore - Drejtor i Departamentit të Rinis	

<b>Ministria e Punës</b>	1	- Drejtor i Departamentit të Administratës Pensionale	
<b>Ministria e Transportit</b>	3	-Drejtor i Drejtorisë se Aviacionit Civil -Drejtor i Drejtorisë së Rrugëve -Drejtor i Njesisë Auditimit të Brendshëm	
<b>Ministria e Forcës së Sigurisë</b>	1	- Drejtor i Departamentit të Prokurimit dhe Kontratave	
<b>Ministria e Pushtetit Lokal</b>	1	- Drejtor i Departamentit për Reforme të Pushtetit Lokal	Paraprakisht e është rekomanduar për vazhdim të konkursit pasi që është plotësuar ky kusht është vëzhguar procedura e regrutimit nga ana e Këshillit.
<b>Agjencioni i Prokurimit Publik</b>	3	- Drejtor i Departamentit për Kontroll dhe Miratime - Drejtor i Departamentit për Prokurimet te Centralizuara dhe Projekte Speciale - Zyrtare Kryesore Financiare	
<b>QKSPEZH</b>	2	- Udhëheqës i Administratë dhe Logjistikes - Udhëheqës i Departamentit për Mbështetje Programore	
<b>Agjencioni i Pyjeve të Kosovës</b>	1	Drejtor i Drejtorisë Koordinuese në Prishtine	
<b>ATK</b>	1	Drejtor për Modernizim dhe Planifikim Strategjik	
<b>Instituti i Avokatit të Popullit</b>	1	Drejtor i Departamentit të Administratës	

Komisioni i Pavarur për Media	1	- Drejtor i Departamentit Ligjor	
Komisioni për Ndhime Juridike	1	- Drejtor i Zyrës së Administratës Qendrore	
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	1	- Kryesues i Departamentit të Gjeodezisë	
Institucioni i Kosovës për Administratë Publike	1	- Drejtor i Administratës	
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	2	- Kryesues i Departamentit për Hulumtim të Aksidenteve - Kryesues i Departamentit të Administratës	
Komuna e Shtërpçës	1	Udhëheqës i Personelit	

## XII. BUXHETI

Këshilli ka bërë hartimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor, duke vlerësuar nevojat financiare për shpenzimet për vitin në vijim. Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për Këshillin, për vitin 2010, ka qenë 207.268.00 €, ndërsa i ndarë sipas kategorive ekonomike, në mënyrë tabelare duket kështu:

Nr.	Kategoritë Ekonomike	Buxheti i Aprov.	Buxheti i rishit.	Ndryshimi
1	Paga dhe mëditje	119.974 00 €	133.345.00 €	+13.371.00
2	Mallra dhe shërbime	74.130.00 €	69.023.00 €	-5.107.00
3	Shpenzime kapitale	.00 €	.00 €	0.00
4	Shpenzimet komunale	2.500.00 €	4.900.00 €	+ 2.400.00
	<b>Totali</b>	<b>196.604. €</b>	<b>207.268. €</b>	<b>10.664.00</b>

*Tabela nr: Alokimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike*

### 1. Mbikëqyrja e shpenzimeve

Gjatë vitit 2010, nga buxheti i miratur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Këshilli ka realizuar 92.93% të buxhetit të paraparë. Buxheti i ndarë për:

- Kategorinë Paga dhe Meditje është shpenzuar në masën **97.82%** .
- Kategorinë Mallra dhe Shërbime është shpenzuar **83.63%** nga buxheti i planifikuar për këtë kategori. Në tabelën e mëposhtme;
- Kategorinë Shpenzimet e komunale është shpenzuar në masën **90.75%** të buxhetit të planifikuar;

Këto të dhëna në mënyrë tabelare duken si më poshtë:

Nr.	Kodi buxhetor	Të aprovuara	Të shpenzuara	Të pa shfrytëzuar	Të shprehura në %
1	<b>Paga dhe meditje</b>	133.345.00	130.433.69	2.911.31	97.82 %
2	<b>Mallra dhe shërbime</b>	69.023.00	57.723.73	11.299.27	83.63 %
3	<b>Shpenzimet komunale</b>	4.900.00	4.446.63	453.37	90.75 %
4	<b>Shpenzime kapitale</b>	00.00	00.00	00.00	0%
	<b>Totali</b>	<b>207.268.00</b>	<b>192.604.05</b>	<b>14.663.95</b>	<b>92.93%</b>

*Tabela: Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike*

## XIV. BASHKËPUNIMI

Këshilli gjatë vitit raportues ka zhvilluar me tej bazat e kultivimit të frymën së bashkëpunimit të mirë me institucione dhe organizata vendore e ndërkombëtare.

Një bashkëpunim të frytshëm Këshilli ka pasur me Misionin e OSBE në Kosovë.

Në këtë drejtim OSBE ndihmoi dhe financoi Këshillin në realizimin e një spoti televiziv publicitar me qëllim të vetëdijesimit të nëpunësve civil për ofrimin e sigurisë juridike nga ana e Këshillit si dhe frymën bashkëpunuese në sensin kur ata besojnë se iu është bërë ndonjë padrejtësi lidhur me rregullat dhe parimet e shërbimit civil nga autoritete punëdhënëse.

Në këtë kuptim spoti i është ekspozuar edhe publikut të gjerë për t'iu dhënë informacion mbi funksionimin e Këshillit si dhe mundësinë që ata kanë të drejtë për t'iu drejtuar këtij organi në rastet kur ata besojnë se si aplikues për rekrutim në Shërbimin Civil iu është bërë e padrejtë dhe përzgjedhja është bërë në kundërshtim me parimin e meritës.

Kjo fushatë ka zgjatur një muaj dhe ka përfshirë edhe shpërndarjen e broshurave dhe postarëve të ndryshëm për rolin dhe kompetencat e këshillit.

Këshilli për herë të parë ka organizuar një konferencë për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të shërbimit civil në Kosovë, ngjarje e cila është përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, në rezolutën e saj 57/277, me të cilin e ka vendosur 23 qershorin - "Ditë Ndërkombëtare të shërbimit civil"

Gjithashtu, Këshilli gjatë vitit 2010 me mbështetje të Misionit të OSBE-së në Kosovë, ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) seminare informative në 11 komuna të Kosovës, (Prishtinë, Gjilan, Mamushë, Prizren, Hani i Elezit, Mitrovicë, Graçanicë, Malishevë, Junik, Pejë dhe Gjakovë) duke i përfshirë pjesëmarrës edhe nga komunat tjera me qëllim të informimit të të gjitha organet e punësimit në nivelin lokal dhe shërbyesit civil të cilat i nënshtrohen zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil.

Temat të cilat janë trajtuar në këto seminare janë roli dhe funksionet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil dhe njohuritë themelore për Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës.

Mbajta e këtyre seminareve ka ndikuar pozitivisht në të akceptuarit e rolit dhe funksioneve të Këshillit nga ana e organeve të punësimit në njërën anë dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e nëpunësit civil në anën tjetër.

### *Vizitat pune dhe ato studimore*

Me qëllim të ngritjes profesionale dhe këmbimit të përvojave me organet analoge në rajon Këshilli gjatë periudhës raportuese ka realizuar dy vizita pune dhe një vizitë studimore.

Në mbështetje të UNDP-së Këshilli ka realizuar një vizitë pune, në Strugë-Maqedoni lidhur me hartimin e rregulloreve të brendshme të Këshillit.

Po ashtu në përkrahje të Misionit të OSBE-së në Kosovë Këshilli ka realizua një vizitë studimore në Bruksel - Institucionet e Bashkimit Evropian dhe në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë dhe Tribunalin e Shërbyesve Civil në Luksemburg.

## XV. PROBLEMET DHE VËSHIRËSITË

Problemet dhe vështirësitë me të cilat është ballafaquar Këshilli gjatë periudhës raportuese mund të përmenden:

- Mos ekzekutimi i disa vendimeve të Këshillit nga ana e disa organeve të punësimit, përkundër që kanë obligim ligjor ta bëjnë një gjë të tillë;
- Mungesa e hapësirës adekuate (objektit) për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit, si rezultat i kësaj Këshilli nuk ka mundur ta bëjë rekrutimin e stafit të nevojshëm të Sekretariatit i cili do të ndihmonte shumë që të zhvillojë një punë me efektive në terren për mbikëqyrjen e institucioneve, lidhur me respektimin e zbatimit të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës.
- Buxheti i pa mjaftueshëm stimulim i pamjaftueshëm financiar për anëtarët e Këshillit (pagat e anëtarëve të Këshillit janë shumë e ulëta dhe jopërkatese për punën dhe statusin që ata e kanë, aq më shumë kur kihet parasysh se paga është edhe më e ulët se baza e pagës së udhëheqësve të lartë në shërbimi civil, apo në institucionet e tjera publike të Republikës së Kosovës
- Mungesa e bashkëpunimit të nevojshëm me institucionet analoge të shteteve të ndryshme që do të mund të ti shërbente Këshillit në marrjen e përvojave të vendeve të BE-së për rolin dhe funksionimin e Këshillit.
- Inventar dhe pajisje elektronike tejet të vjetruara etj.

## XVI. SFIDAT E SË ARDHMES

Këshilli në të ardhmen do të përballë me sfida të mëdha gjatë ushtrimit të funksioneve të veta.

Ekziston mundësia që shumica e problemeve me të cilat Këshilli është ballafaquar në vitin 2010 të barten edhe në vitin 2011, siç janë: mundësia e mos ekzekutimit të vendimeve të Këshillit nga ana e organeve të punësimit, buxheti i pa mjaftueshëm për të kompletuar gjithë stafin profesional të Sekretariatit për realizimin e objektivave të Këshillit, përmirësimin e kushteve dhe stimulimin e mjaftueshëm financiar për anëtarët e Këshillit dhe stafin e sekretariatit në nivelin e agjencive dhe institucioneve tjera të pavarura; mungesën e hapësirave adekuate për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit.

Po ashtu Këshilli do të përballë edhe me sfida tjera pasi që në vitin 2010 është miratuar nga ana e Kuvendit Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës e cili sigurisht do të ketë vështërsi në zbatimin e tij nga ana e organeve të punësimit, kjo për shkakun e dinamikës së ngadalte të nxjerrjes së akteve përcjellëse në zbatim të këtij ligji nga ana e MAP-it në njërin anë, dhe mungesës së sensibilizimit të OP nga ana tjetër.

E terë kjo do të ndikoj në rritjen e vëllimit të aktiviteteve të Këshillit për ushtrimin e funksioneve të veta.

Këshilli për vitin 2011 planifikon marrjen e masave dhe përgjegjësve të shërbimit civil, nëpër organet e punësimit të dy niveleve si atë qendrorë ashtu edhe atë lokal. Kjo do të bëhet për ngritjen e vetëdijes së tyre për domosdoshmërinë e ekzekutimit të vendimeve të Këshillit duke u mbështetur në Ligjet dhe parimet e Shërbimit Civil. Për të realizuar me sukses këtë objektiv Këshilli nuk ka mjete të mjaftueshme financiare, prandaj mund të përballemi me sfida që e rrezikojnë realizimin e këtij objektivi.

## XVII. PËRFUNDIM

Gjatë periudhës raportuese Këshilli ka hasur në vështirësi të theksuara të cilat e kanë penguar këtë institucion për përmbushjen me përpikëri të tri funksioneve të cilat ia përcakton ligji.

Përkundër vështirësive financiare, por edhe me mungesë të stafit ndihmës profesional, Këshilli gjatë vitit 2010 ka demonstruar përkushtimin dhe vendosmërinë për tu përballur me ankesat e nëpunësve civil dhe aplikuesëve, duke i zgjedhur edhe ankesat e bartura nga vitet paraprake.

Mos ekzekutimi i vendimeve të Këshillit nga ana e disa organeve të punësimit ishte një brengë dhe sfida me e madhe për Këshillin.

Këshilli, për zbatimin e vendimeve nga ana e organeve të punësimit në nivel qendrorë dhe lokal, pret angazhimin e Qeverisë, të eprorëve të drejtpërdrejtë (Ministrat, Kryetarët e Komunave), të nëpunësve të lartë drejtues të institucioneve (Sekretarët e Përgjithshëm, Kryeshefat Ekzekutiv, Drejtorët Ekzekutiv dhe udhëheqësit e Bordeve), Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Gjykatave, që vendimet e Këshillit të zbatohen përfundimisht konform ligjit për Këshillin.

Përkushtimi i fuqishëm i Këshillit vazhdon të mbetet sigurimi i një Shërbimi Civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të besueshëm dhe gjithmonë sipas rregullave dhe parimeve të shërbimit civil.